



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.253/5 prot

Datë 22.02.2024

V E N D I M
Nr. 214/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|------------------|------------|
| Jonaid Myzyri | Kryetar |
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |
| Anila Malaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 22.02.2024, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Modifikim i dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-93857-01-26-2024 me objekt “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së software-ve”, me fond limit 13,980,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 14.02.2024, nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Primus Albania” SHPK me NIPT L42202028V dhe adresë: Rruga “Margarita Tutulani”, pallati Viridario 1, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A me adresë: L.17 Rr. “Dalip Peza”, Durrës.
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit

të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.01.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-93857-01-26-2024 me objekt “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së software-ve”, me fond limit 13,980,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 14.02.2024, nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.

II.2. Në datën 01.02.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/2786, protokolluar me nr. 253 prot., datë 02.02.2024, e operatorit ekonomik “Primus Albania” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 179/35 prot., datë 05.09.2024, protokolluar me tonën me nr. 253/2 prot., datë 07.02.2024, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik

informacioni i autoritetit kontraktor, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Primus Albania” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Referuar shkresës së sipërcituar të autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka refuzuar trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Primus Albania” SHPK duke argumentuar se: *“Referuar ankesës së operatorit ekonomik “PRIMUS ALBANIA” me Nipt L42202028V, të publikuar në faqen zyrtare të KPP me Nr. 25312024 Prot. Datë 02.02.2024, protokolluar me tonën Nr. 179/27 Prot. Datë 02.02.2024 , në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së software-ve” me nr. REF-93857-01-26-2024 , me fond limit 13,980,000 (Trembëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSh ju bëjmë me dije si më poshtë: Autoriteti Kontraktor SHRUKD sh.a me datë 26.01.2024 ka dërguar për publikim njoftimin e shkurtuar të kontratës për prokurimin me objekt: “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së software-ve” me nr. REF-93857-01-26-2024.*

Më datë 29.01.2024 Agjencia e Prokurimit Publik ka publikuar njoftimin e shkurtuar të kontratës.

Më datë 01.02.2024 Autoriteti Kontraktor ka vendosur të anulojë procedurën duke dërguar Formularin e Anulimit për publikim referuar kërkesës me Nr.179121 Prot. Datë 01.02.2024, të grupit të hartimit të specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, për shkak të konstatimit të disa mangësirave të rëndësishme në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Më datë 02.02.2024 Agjencia e Prokurimit Publik ka publikuar Formularin e Anulimit për procedurën me objekt: “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së softwareve” me nr. REF-93857-01-26-2024.”

II.6. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit publik rezulton, se më datë 02.02.2024, është publikuar anulimi i procedurës së prokurimit objekt - ankimi. Gjithashtu, në buletin e njoftimeve publike të Agjencisë së Prokurimit Publik, me nr. 6, datë 05.02.2024, është publikuar formulari i anulimit të procedurës objekt – ankimi, ku në pikën 6 të tij citohet:

6. Arsyet e Anulimit:

Bazuar në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 98, pika 1:

a) ;

b) ;

c) për shkak se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit, për modifikimin e kritereve për kualifikim dhe kërkesat për sqarim, për dokumentet e procedurës së prokurimit objekt - ankimi, KPP vëren se:

III.1.1. Njëpërmjet shkresës nr. 179/35 prot., datë 05.09.2024, protokolluar me tonën me nr. 253/2 prot., datë 07.02.2024, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Primus Albania” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.2. Referuar shkresës së sipërcituar të autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka refuzuar trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Primus Albania” SHPK, duke argumentuar se: *“Referuar ankesës së operatorit ekonomik “PRIMUS ALBANIA” me Nipt L42202028V, të publikuar në faqen zyrtare të KPP me Nr. 253/2024 Prot. Datë 02.02.2024, protokolluar me tonën Nr. 179/27 Prot. Datë 02.02.2024, në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së software-ve” me nr. REF-93857-01-26-2024, me fond limit 13,980,000 (Trembëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSh ju bëjmë me dije si më poshtë: Autoriteti Kontraktor SHRUKD sh.a me datë 26.01.2024 ka dërguar për publikim njoftimin e shkurtuar të kontratës për prokurimin me objekt: “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së software-ve” me nr. REF-93857-01-26-2024.*

Më datë 29.01.2024, Agjencia e Prokurimit Publik ka publikuar njoftimin e shkurtuar të kontratës.

Më datë 01.02.2024 Autoriteti Kontraktor ka vendosur të anulojë procedurën duke dërguar Formularin e Anulimit për publikim referuar kërkesës me Nr.179/21 Prot. Datë 01.02.2024, të grupit të hartimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, për shkak të konstatimit të disa mangësirave të rëndësishme në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Më datë 02.02.2024 Agjencia e Prokurimit Publik ka publikuar Formularin e Anulimit për procedurën me objekt: “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së softwareve” me nr. REF-93857-01-26-2024.”

III.1.3. Neni 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Në nenin 3 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Në nenin 21 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat

e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

Në nenin 34 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor në fazën e hartimit të nevojave të tyre për mallra, punë, shërbime mbajnë në konsideratë metodat e përlllogaritjes së vlerës së prokurimit. Vlera e përlllogaritur e prokurimit duhet të jetë vlerë reale përpara dërgimit për publikim të njoftimit të kontratës.”.*

III.1.4. Në nenin 94, pika i “Paraqitja e ankesave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP-së, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe komisionit të prokurimit publik.”.

III.1.5. Në nenin 98 pika 1/ç dhe pika 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;

b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

ç) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;

d) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj.

2. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në pajtim me shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij neni, autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt prokurimi e me të njëjtat të dhëna.

3. Autoriteti ose enti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni.

4. Autoriteti ose enti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit menjëherë, por jo më vonë se 3 ditë nga marrja e vendimit.

5. Autoriteti ose enti kontraktor publikon vendimin e anulimit vetëm pas kalimit të afateve të ankimimit sipas parashikimeve të nenit 110 të këtij ligji.”.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik,

duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.1.7. Sa më sipër, konstatohet, se autoriteti kontraktor më datë 01.02.2024, ka anuluar procedurën e prokurimit, me justifikimin se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme, anulim i cili është publikuar në SPE më datë 02.02.2024. Po ashtu operatori ekonomik ankimues më datë 01.02.2024, ka paraqitur nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike një ankesë, njëherazi në autoritet kontraktor dhe në KPP, me numër ankimi elektronik A/2024/2786 protokolluar në KPP, me nr. 253 prot., datë 02.02.2024, për procedurën e prokurimit të anuluar, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit. Gjithashtu, autoriteti kontraktor në aktin e trajtimit të ankesës, ka refuzuar trajtimin e saj, pasi kryesisht kishte evidentuar gabime ose mangësi të rëndësishme në dokumentet e tenderit dhe për këtë, ka anuluar procedurën e prokurimit bazuar në nenin 98, pika c, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”. Në këtë kuadër, Komisioni konstaton, se ankesa e operatorit ekonomik nuk ka më objekt dhe ka rënë në dekadencë, pasi referuar parashikimeve të nenit 94, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, interesi i ligjshëm i ankimuesit është i lidhur me veprimet apo mosveprimet e autoritetit kontraktor, ndërsa në rastin konkret veprimi i autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës do të çojë në rishikimin thelbësisht të kriterëve për kualifikim dhe të termave të referencës dhe kjo krijon konfuzion për Komisionin e Prokurimit Publik gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, sepse hartimi i kriterëve kualifikuese është i lidhur ngushtësisht me qëllimin e vendosjes së tyre dhe nëpërmjet tyre autoriteti kontraktor, kërkon që të arrijë sigurimin e shërbimit të kërkuar në kohë dhe cilësi dhe me sa më pak kosto.

Ndërkohë vetë autoriteti kontraktor, si organi përgjegjës i zhvillimit të procedurës së prokurimit prokurimi, duhet të marrë masa për rishikimin thelbësor të kriterëve për kualifikim të procedurës së prokurimit që do të ripublikojë, si dhe të hartojë termat e referencës dhe specifikimet teknike në përputhje me këto kriterë.

Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Primus Albania” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-93857-01-26-2024, me objekt “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së software-ve”, me fond limit 13,980,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 14.02.2024, nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit objekt-ankimi.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Primus Albania” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

